

# REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
01	16/11/2023	<p>Kërkesë për informacion:</p> <p>Ne kete kuader, do te doja t'ju pyesja nese ju si institucion keni nje kendveshtrim mbi kete ceshtje.</p> <p>Si e konsideroni faktin qe brenda fondit pyjor dhe kullosor te zhvillohen keto lloj projektsh?</p> <p>A eshte kerkuar nje opinion nga bashkete prane institucionit tuaj, mbi keto procedura?</p> <p>A mendoni se ky lloj zhvillimi demton fondin pyjor dhe kullosor?</p>	19/12/2023	<p>Bazuar ne ligjin e pyjeve 57/2020 “Per pyjet” bashkete jane administratore te fondit pyjor qe gjenden brenda territorit te bashkise se tyre.</p> <p>Per sa i perket centraleve fotovoltaike jane aktivitte te parashikuara nga ligji I pyjeve dhe udhezimi nr.1 date 06.09.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor public”</p> <p>Ne rastin e investimeve te tilla te rendesise strategjike paraprakisht merret mendimi dhe miratimin I keshillit bashkiak duke vijuar me miratimin nga ‘Keshilli Kombetar I territorit’, “ERE”, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agejncia Kombetare e Pyjeve</p> <p>Në disa raste, vendosja e paneleve fotovoltaike mund të prekë habitatet natyrore dhe të ndikojë në speciet e faunës dhe florës vendore. Planifikimi i kujdesshëm dhe monitorimi i vazhdueshëm janë thelbësore për zvogëlimin e ndikimeve negative.</p> <p>Zhvilluesi parashikon te gjithe ndehyrjet ne fondin pyjor sidomos per shtrimin e linjes se tensionit te larte dhe merr pergjegjesione e kompensimit te drureve te prere sipas dispozitave ligjore ne fuqi.</p> <p>Agjencia Kombetare e pyjeve nuk ka ndermarre ndonje studim mbi efektet qe shkaktojne centralet ne fondin pyjor si</p>	Përfunduar	Nuk ka

				<p>aktivitete relativisht te reja dhe me efekte positive ne ruajtjen e krijimin e rezervave energjitike. Nga an tjetër prodhimi I energjise nga burime te rinovueshme ul presionin mbi perdorimin e drurit, rrit te ardhurat e bashkisë nga qeraja vjetore qe dote paguaje subjekti, per ti rikthyer ne investimene pyje.</p> <p>Centralet fotovoltaike janë nga industritë më të pastra, në prodhimin e energjisë elektrike dhe me emetime minimale ne mjedis mbasi vendosj e tyre behet mbi struktura 1.5-2 m te larta duke mos demtuar siperfaqen dhe bimesin e e ulët pyjore, jane siperfaqe qe mund te perdoren edhe per kullotje mbasi struktura e tyre e lejon.</p>		
02	21/12/2023	<p>Kërkesë për informacion: Më konkretisht kërkoj,</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kopje të Regjistrit Kombëtar të fondit pyjor në vend.</li> <li>2. Kopje të raporteve vjetore mbi gjendjen e fondit pyjor (për 2020, 2021, 2022, 2023).</li> <li>3. Kopje e raportit kombëtar të miratuar të pyjeve (Inventari).</li> <li>4. Të dhënat e Kadastrës së Pyjeve për tri vitet e fundit, sipas modelin të miratuar</li> </ol>	27/12/2023	<p>1-Lidhur me kërkesën e parë, mbi <i>Kopjen e Regjistrit Kombëtar të fondit pyjor në vend</i>, ju bëjmë me dije se kërkesa është e përsëritur në pikën 4 mbasi “Regjistri Kombëtar i Fondit Pyjor (RKFP)” është regjistri zyrtar i të dhënave kadastrale të fondit pyjor kombëtar, i organizuar në nivel qendror, rajonal dhe vendor, në të cilin regjistrohen të gjitha informacionet bazë dhe ndryshimet periodike të ndodhura në pronësinë, të drejtat reale, pozicionin hartografik, sipërfaqe, volum etj., shoqëruar me sistemin e informacionit gjeografik (GIS), i nevojshëm për administrimin dhe planifikimin e pyjeve.</p> <p>2-Lidhur me kërkesën e dytë, mbi <i>Kopjen e raporteve vjetore mbi gjendjen e fondit pyjor (për 2020, 2021, 2022 dhe për vitin 2023)</i>, ju bëjmë me dije se:</p> <p>-Raporti i vitit 2020 është hartuar si dhe botuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit si pjesë e Raportit të Gjendjes së Mjedisit</p>	Përfunduar	Nuk ka

			<p>(RGJM 2020), ku pjesë e tij është edhe kapitulli mbi pyjet.</p> <p>-Raporti vjetor 2021 dhe 2022 mbi gjendjen e Pyjeve, është hartuar nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve dhe është botuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit si pjesë e Raportit të Gjendjes së Mjedisit (RGJM 2021, RGJM 2022).</p> <p>-Raporti vjetor i gjendjes së pyjeve 2023 hartohet dhe botohet gjatë tremujorit të parë të vitit 2024.</p> <p><a href="https://akm.gov.al/raporte-dhe-publikime/">https://akm.gov.al/raporte-dhe-publikime/</a></p> <p>3-Lidhur me kërkesën e tretë, mbi <i>Kopjen e Raportit Kombëtar të miratuar të pyjeve (Inventari)</i>, ju bëjmë me dije se të dhënat përfundimtare u analizan nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve si pjesë e procesit të Inventarit Kombëtar të Pyjeve dhe Kullotave (IKPK), dhe gjithashtu është botuar një libër me treguesit kryesorë të IKPK-së për vitin 2021.te cilin e gjeni të publikuar në web-in e AKP-së ne linkun</p> <p><a href="https://akpyje.gov.al/inventari-kombetar-i-pyjeve-dhe-kullotave-ikpk-2021/">https://akpyje.gov.al/inventari-kombetar-i-pyjeve-dhe-kullotave-ikpk-2021/</a></p> <p>4-Lidhur me kërkesën e katërt, mbi <i>Të dhënat e Kadastrës së Pyjeve për tri vitet e fundit</i>, sipas modelit të miratuar, ju bëjmë me dije se për të dhënat kadastarle, ose të dhënat e Regjistrit Kombëtar të Pyjeve, ka nisur plotësimi i të dhënave sipas standartit të vendosur me VKM-në nr. 171, datë 18.3.2022, “Për ngritjen e bazës së të dhënave për regjistrin kombëtar të fondit pyjor dhe regjistrin e fondit kullosor, përcaktimin e strukturës, kriterëve teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mënyrës së mbajtjes së të dhënave në nivel vendor, rajonal e qendror,</p>	
--	--	--	---	--

				<p>informacionit që duhet regjistruar, si dhe të afateve të përgatitjes e raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve”,  Për sa më sipër jemi ne proces të azhurnimit dhe përditësimit të të dhënave për dy format e pronësisë:  1-Pyje Publike (me administartorë 61 bashkitë, 12 drejtoritë rajonale të zonave të mbrojtura (AdZM), Agjencinë e Turizmit për sipërfaqet e përcaktuara në VKM - në nr. 707 datë 21.11.2018 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizmin të disa pronave të paluajtshme shtetërore, në vijën bregdetare Shkodër–Fier”)  2-Pyje Private në pronësi të pronarëve, entiteteve fetare apo bashkëpronarë.</p>		
03	26/12/2023	Kërkesë për informacion: Kërkojmë informacion për planet e mbarështimit të miratuara nga institucioni juaj nga periudha 1 janar 2020 deri në 26 dhjetor 2023, për bashkitë të cilat i kanë hartuar këto plane.	19/01/2024	<p>Në përgjigje të kërkesës:  ”Informacion për planet e mbarështimit të miratuara nga institucioni juaj nga periudha 1 janar 2020 deri në 26 dhjetor 2023, për bashkitë të cilat i kanë hartuar këto plane”.  Ju bëjme me dije se:  Planet e Mbarështimit referuar nenit 11 të ligjit 57/2020 “Për Pyjet” miratohen nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, ndaj duhet të drejtorheni MTM-se mbasi ne nuk e disponojmë informacionin e detajuar që ju kërkoni.</p>	Përfunduar	Nuk ka
04	28/12/2023	Kërkesë për informacion: Bazuar në VKM e 2022. Atëherë më jepni të dhënat e kadastrës së pyjeve të vitit 2015 dhe të vitit 2021. Pra, përpara përditësimit që po kryeni.	19/01/2024	<p>Në përgjigje të kërkesës për:  “Të dhënat e kadastrës së pyjeve të vitit 2015 dhe të vitit 2021. Pra, përpara përditësimit që</p>	Përfunduar	Nuk ka

			<p><i>po kryeni.”</i></p> <p>Ju bëjmë me dije se AKP e krijuar në vitin 2020 nuk disponon të dhëna të vitit 2015. Të dhënat kadastrale të vitit 2021 janë jo të plota për shkak të mungesës së informacionit standart nga shume bashki si dhe kohës që duhet për popullimin me të dhëna dhe funksionimin zyrtar të sistemit ALFIS.</p>		
--	--	--	--	--	--